

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 32489/19

Bashkim DEDJA kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 15 tetor 2024 si Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *Kryetar*,

Darian Pavli,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit*,

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 32489/19) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") më 17 qershor 2019 nga shtetasi shqiptar z. Bashkim Dedja ("kërkuesi"), i lindur në vitin 1970, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. L.Bianku, avokat i licencuar në Shqipëri;

vendimin për të njoftuar për ankimet sipas nenit 6 dhe 8 të Konventës Qeverinë shqiptare ("qeveria"), të përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e depozituara nga Qeveria e paditur dhe prapësimet e paraqitura nga kërkuesi;

komentet e depozituara nga Res Publica që u pranuan për ndërhyrje nga Kryetari i Seksionit;

vendimin e Dhomës së Gjykatës për të refuzuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e Darian Pavli, gjyqtar i zgjedhur për Shqipërinë (Rregulli 28 § 4 i Rregullores së Gjykatës);

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me procedurat e vetingut që rezultuan në shkarkimin e kërkuesit nga gjyqësori.
2. Kërkuesi e nisi karrierën e tij gjyqësore në vitin 1993, shërbeu në Gjykatën e Apelit Durrës nga 1998 deri në vitin 2010 dhe në fund si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë (me një mandat 9-vjeçar që mbaronte në vitin 2019) dhe si Kryetar i saj.

3. Një nga vëllezërit e kërkuesit, L.D kishte në pronësi një apartament në Golem, Bashkia Kavajë. Në vitin 2004, kërkuesi nënshkroi kontratën e furnizimit me energji elektrike për atë apartament dhe e përdori disa herë në vitet në vijim; ai nuk deklaroi përdorimin e tij në deklarinë vjetor të pasurisë.

4. Në kuadër të procesit të vetingut përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) (shihni *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021), në vitin 2017, kërkuesi paraqiti deklarinë e pasurisë për veting. Ai nuk deklaroi përdorimin nga ana e tij të apartamentit në Golem. Në përgjigje të pyetësorit nga KPK-ja, ai tha që e kishte përdorur atë apartament ndonjëherë, dhe kishte nënshkruar kontratën e lartpërmendur, sepse në atë kohë punonte afër Durrësit dhe L.D. banonte tjetërkund.

5. KPK shqyrtoi çështje të ndryshme në lidhje me apartamentet me sip. 98 m² dhe 146 m² në Tiranë dhe përdorimin e apartamentit në Golem. Me vendim të 13 qershorit 2018, KPK-ja konfirmoi emërimin e kërkuesit si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

6. Komisioneri Publik (KP) e ankimoi në KPA dhe kërkoi shkarkimin e kërkuesit nga detyra duke pretenduar *inter alia* si më poshtë.

a) Sipas rregulloreve në fuqi, kontrata e furnizimit me energji elektrike u lidh me pronarët. Kontrata për apartamentin në Golem e përfshiu kërkuesin brenda gamës së përdoruesve ose personave që gëzojnë një të "drejtë reale" sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës; pronari i apartamentit ishte "person tjetër i lidhur", për të cilin duhej të provohej ligjshmëria e burimit për blerjen e apartamentit. Të ardhurat e ligjshme të L.D. ishin të pamjaftueshme për të justifikuar pasuritë e tij.

b) Në lidhje me apartamentin 98 m², kërkuesi dhe M.D. (vëllai tjetër i tij) e gëzonin atë në bashkëpronësi. Në deklarinë e vitit 2003, kërkuesi tregoi si burim të blerjes së asaj prone pagën dhe

të ardhurat e krijuara nga M.D. gjatë qëndrimit jashtë që në vitin 1993. Megjithatë, në deklaratën e vetingut në vitin 2017, kërkuesi deklaroi pronësinë e tij të plotë dhe tregoi si burim kursimet dhe të ardhurat e tij. Ai shpjegoi se në vitin 1997, vëllezërit kishin blerë apartamentin me qëllim që ta paguanin bashkë, edhe pse kontrata fillestare ishte vetëm në emrin e kërkuesit; pasi kishte marrë leje qëndrimi në Greqi dhe pasi kishte krijuar familje atje, M.D. kishte humbur interes për atë apartament. KP-ja shpjegoi se neni D § 2 i aneksit të Kushtetutës dhe neni 32 i ligjit për vetingun (LV) kërkonin që kërkuesi të paraqiste prova nga M.D. dhe të jepte detaje dhe kronologji në lidhje me kontributin e vëllait dhe ri-caktimin e pjesës së tij në favor të kërkuesit.

c) Kërkuesi kishte deklaruar si burim kredinë bankare, kursimet e familjes dhe hua prej 10,000 euro (EUR) dhe 15,000 EUR nga E.C. dhe M.D. përkatësisht. Megjithatë, sipas analizës së KP-së ata nuk kishin të ardhura të mjaftueshme dhe të ligjshme për para borxh. Në vitin 2014 M.D. mori një kredi bankare prej 25,000 EUR, ndërkohë që në vitin 2013 ai i kishte dhënë kërkuesit hua pa interes në shumën 15,000 EUR.

d) Bazuar në të dhënat e dosjes përpara K.P.K., kishte një mospërputhje ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të kërkuesit (shpenzime jetese, udhëtimi dhe të tjera) dhe një diferencë negative që varionte nga 21.318 dhe 3.516.645 lekë shqiptarë (ALL) në vit nga 2010 deri më 2015 për një shumë të përgjithshme prej mbi 4.560.000 lekë.

7. Kërkuesi mori ankimin e KP-së në korrik 2018 dhe u njoh me dosjen e çështjes në tetor 2018. Në dhjetor 2018 ai dorëzoi parashtrimet me shkrim në KPA. Në veçanti, ai shpjegoi se nuk e kishte deklaruar përdorimin prej tij të apartamentit në Golem, sepse nuk e vlerësonte që ekzistonte ndonjë marrëdhënie specifike juridike civile për të deklaruar përdorimin e apartamentit në rastet e pushimeve zyrtare; që pagesa nga ana e tij e energjisë elektrike nuk përbënte provë që ai ishte pronari i vërtetë. Ai dorëzoi dokumente në lidhje me huadhënësit e tij dhe fondet e tyre.

8. Gjithashtu kërkuesi dorëzoi: (i) një shkresë me datë 11 dhjetor 2018 dhe dokumente nga Gjykata Kushtetuese për të treguar se ajo kishte paguar shpenzimet në shumën 1.441.927 lekë në vitin 2011 dhe 2013 deri në 2014 për udhëtimet e tij zyrtare, dhe për të hequr këtë shumë nga shpenzimet e tij personale; (ii) një deklaratë nga M.D. që konfirmonte të ardhurat e tij; dhe (iii) informacion nga Interneti për të përjashtuar KP-në.

9. Më 12 dhjetor 2018, kërkuesi mori pjesë në një seancë dëgjimore përpara KPA-së. Më 17 dhjetor 2018, KPA-ja shfuqizoi vendimin e KPK-së duke dhënë arsyetimin e mëposhtëm.

a) Dokumentet e përmendura në paragrafin 8 më lart ishin të *panevojshme* sipas kuptimit të nenit 49 (6) (a) të LV-së (shihni *Xboxhaj* cituar më lart, § 146) dhe prandaj ju kthyen kërkuesit. Në veçanti, deklarata e fundit e M.D. ishte në thelb e njëjtë me provën që ndodhej tashmë në dosje.

b) Sipas nenit D § 1 të aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre. Sipas nenit D § 5, nëse subjekti i rivlerësimit *përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë* në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Kërkuesi e kishte përdorur për shumë vite apartamentin në Golem, por nuk e kishte deklaruar as në deklaratën e vetingut as në deklaratat vjetore. KPA-ja doli në përfundimin që kërkuesi *“kishte pasaktësi në deklarim”* në lidhje me përdorimin e kësaj prone, fakt ky që bie në kundërshtim me nenin D §§ 1 dhe 5" (shihni *Xboxhaj*, cituar më lart, § 108).

c) Kërkuesi kishte burime të justifikuara ligjërisht të pamjaftueshme për apartamentin me sip. 98 m² të porositur në vitin 1997, sidomos për këstin e parë prej 68.117 lekë, me një diferencë të përgjithshme negative prej 1.035.652 lekë në kohën në fjalë. Nuk është provuar kontributi i M.D. për financimin e apartamentit. Ai ishte deklaruar si bashkëpronar në deklaratën e vitit 2003, ndërsa kërkuesi është deklaruar si pronari i vetëm në deklaratën e vetingut. Sidoqoftë, kontributi i M.D. duhej të deklarohet në deklaratën e vetingut, edhe nëse më pas i është kthyer, siç pretendohet. Kërkuesi nuk e ka treguar burimin e ligjshëm të të ardhurave të M.D-së.

d) Në vitin 2013, kërkuesi kishte marrë hua private në shumën 10,000 EUR dhe 15,000 EUR nga E.C. dhe M.D. për të financuar pjesërisht apartamentin me sip. 146 m² në Tiranë. Gjatë procesit të

vettingut, kërkuesi duhej të justifikonte ligjshmërinë e fondeve të huazuara dhe ta mbështeste këtë me prova, siç e kërkon neni D § 3 i aneksit të Kushtetutës, neni 32 (4) i LV-së dhe udhëzimi i ILDKPI-së nr. 4095, datë 10 tetor 2016. Ai nuk provoi që M.D dhe E.C kishin paguar detyrimet për të ardhurat e tyre të fituara jashtë vendit të cilat ai pretendoi se ishin burimi i huave. Në vlerësimin e provave të paraqitura nga kërkuesi sipas nenit 49 (5) të LV-së, KPA-ja doli në përfundimin, se: (i) nuk provoi që për të ardhurat e M.D. në Greqi ishin paguar detyrimet; dhe (ii) ndërsa mund të konsiderohej që 17,741 euro ishin të ardhura të E.C. nga një burim i ligjshëm në Itali dhe për të cilat ishin paguar detyrimet, kjo nuk ishte provuar për të ardhurat e pretenduara në shumën 41.994 EUR në vitin 2010 deri më 2013. Sipas legjislacionit për vettingun, vetëm të ardhurat për të cilat ishin paguar detyrimet përkatëse mund të konsideroheshin “të ardhura të ligjshme” që mund të justifikonin shpenzimet personale ose blerjen e pasurive.

e) “Duke pasur parasysh të gjitha dokumentet”, KPA-ja konkludoi se kërkuesi kishte një bilanc financiar pozitiv (aktive likuide) për 2013 dhe një bilanc negativ të kombinuar për 2011, 2012, 2014 dhe 2015 për shumën 1.068.000 lekë (përafërsisht 7,700 euro).

KPA-ja konkludoi se kërkuesi kishte më shumë pasuri se sa mund të justifikonte ligjërisht dhe nuk kishte deklaruar plotësisht pasuritë në përdorim të tij; që gjetjet e mësipërme tregonin se ai nuk arrinte një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive në përputhje me nenet 59 (1) (a) dhe 61 (3) të LV-së (shihni Xhoxhaj, cituar më lart, § 151).

10. Në një proces të veçantë në vitin 2021, gjykata miratoi sekuestrimin e disa pronave të dyshuara se i përkisnin kërkuesit. Më 26 qershor 2023, ai u dënua sipas nenit 257/a të Kodit Penal (Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim). U vlerësua që ai ishte pronari përfitues i apartamentit në Golem dhe e kishte fshehur këtë fakt. Ankimi i kërkuesit kundër këtij dënimi është në pritje përpara Gjykatës së Apelit.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Objekti i çështjes

11. Në formularin e kërkesës në 2019, kërkuesi u ankua sipas nenit 6 që nuk ishte zhvilluar seancë dëgjimore e drejtë përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) dhe që shkarkimi i tij nga detyra përbënte shkelje të nenit 8 të Konventës. Në vitin 2023, këto ankime ju komunikuan Qeverisë së paditur. Pjesa tjetër u shpall e papranueshme nga zëvendës kryetari i Seksionit dhe kërkuesi u informua që ai vendim ishte përfundimtar.

12. Në vitin 2024 në prapësimet e tij ndaj parashtrimeve të Qeverisë për ankimet e komunikuar, kërkuesi: (i) shtjelloi ankimet që në thelb ishin të njëjta me ato që ishin shpallur të papranueshme; dhe (ii) referoi, për herë të parë, çështje të tjera, të cilat nuk shtjellonin ankimet e komunikuar. Nëse do të kuptohej se ai synonte t'i referonte Gjykatës pretendime të reja në lidhje me vendimin e KPA-së në vitin 2019, ato nuk u depozituan në përputhje me Rregullin 47 §§ 1, 2 dhe 5.1 të Rregullores së Gjykatës. Prandaj, ato parashtrime janë jashtë objektit të kësaj çështjeje në gjendjen që është dhe Gjykata nuk do t'i shqyrtojë (shihni *Fu Quan, s.r.o kundër Republikës Çeke* [DHM], nr. 24827/14, §§ 137 dhe 144-48, 1 qershor 2023, dhe *Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë*, nr. 29943/18, §§ 75 dhe 79, 4 prill 2023).

B. Neni 8 i Konventës

1. Parashtrimet e palëve

13. Qeveria u shpreh se që në vitin 2003, legjislacioni shqiptar parashikonte kërkesën ligjore për deklarimin e pasurisë dhe justifikimin e origjinës së saj të ligjshme dhe për përgjegjësinë për mosdeklarim ose deklarim të rremë, Siç vijoi nga hetimi administrativ, kërkuesi e kishte përdorur apartamentin në Golem dhe L.D. nuk kishte qëndruar atje. Ai e kishte fshehur përdorimin e atij apartamenti për disa vite, gjë kjo që përbën shkelje të rëndë etike dhe ligjore.

14. Kërkuesi pretendoi se shkarkimi i tij nga detyra nuk ishte “në përputhje me ligjin”, sidomos sepse neni 61 (3) i LV-së kërkonte që të provohet se subjekti i vettingut kishte fshehur pasurinë me dashje. Shkarkimi i tij nuk ndoqi një qëllim legjitim dhe nuk ishte proporcional, sepse bazohej në pasaktësi të vogla në deklarimet e tij. M.D. dhe E.C. kishin qenë emigrantë në Greqi dhe Itali për shumë vite dhe kishin paguar atje detyrimin mbi të ardhurat e tyre, siç tregohet në dokumentet e

dosjes. Gjetjet e KPA-së për apartamentin në Golem ishin arbitrare dhe, sidoqoftë, tregonin vetëm një pasaktësi të vogël. L.D. e kishte blerë apartamentin dhe kërkuar nuk kishte detyrimin që ta deklaronte, apo të justifikonte origjinën e ligjshme të fondeve të L.D. për blerjen e tij.

15. Ndërhyrja nga pala e tretë argumentoi se neni D §§ 3 dhe 4 i aneksit të Kushtetutës dhe neni 3 (19) i LV-së duhej të interpretoheshin si të tilla që çdo aktivitet që gjeneron të ardhura, të cilat nuk janë të paligjshme, duhej të konsiderohej si burim i ligjshëm i të ardhurave; interpretimi i rreptë i kësaj ligjshmërie që si gjithmonë kërkon pagimin e taksave ishte i tepruar dhe nuk mbante parasysh informalitetin e transaksioneve në Shqipëri, sidomos ndërmjet familjarëve, si ata që fitojnë të ardhura jashtë vendit. KPA-ja nuk kishte standarde specifike për të vlerësuar përmbushjen e detyrimit për të provuar ligjshmërinë – përfshirë origjinën e ligjshme – të të ardhurave të huaja të një personi tjetër (për shembull, huadhënësi); deklarimi automatik i këtyre të ardhurave si të paligjshme duke ju referuar detyrimeve për të paguar taksat ishte i tepruar dhe i paarsyeshëm për të rezultuar në shkarkimin nga detyra sipas nenit 61 (3) të LV-së; duhej të zbatohej një standard më i lehtë i të provuarit sipas nenit 32 (1).

2. Vlerësimi i Gjykatës

16. Shkarkimi nga detyra i kërkuar përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës private (shihni *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, §§ 131 dhe 135, 4 korrik 2023) dhe do të përbënte shkellje të nenit 8 të Konventës nëse nuk mund të justifikohet që është në përputhje me ligjin dhe i nevojshëm në një shoqëri demokratike për të arritur një qëllim legjitim.

17. Kërkuar u shkarkua nga detyra për mosdeklarimin në deklaratën e vetingut të përdorimit të pasurisë në pronësi të vëllait të tij. Ai nuk u shkarkua, sepse nuk justifikoi origjinën e ligjshme të fondeve të atij personi për blerjen e asaj pasurie. Pa diskutim ligji shqiptar që në vitin 2003 kërkonte që gjyqtarët shqiptarë të deklarojnë rastet e përdorimit (shihni edhe *Xboxhaj*, cituar më lart, §§ 108 dhe 201-02). Argumentet e tjera të kërkuar që kundërshtojnë ligjshmërinë e ndërhyrjes sipas nenit 8 janë të ngjashme me ato tashmë të refuzuara (shihni *Thanza* cituar më lart, §§ 141-45, me referenca të mëtejshme), ose nuk kanë lidhje me gjetjet e bëra sipas nenit 61 (3) të LV-së për vlerësimin e pasurisë. Pyetjet nëse KPA-ja vërtetoi që kërkuar kishte fshehur përdorimin e apartamentit dhe synimin e tij për ta fshehur atë, kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit, siç interpretohet nga KPA-ja, për rrethanat e çështjes së tij dhe pasojat e mundshme disproporcionale të atij interpretimi. Ato çështje kanë lidhje me vlerësimin më poshtë nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike (shihni *Thanza*, cituar më lart, §§ 144). Vijon që ndërhyrja ishte “në përputhje me ligjin” në atë drejtim.

18. Gjykata gjithashtu refuzon në këtë pikë argumentet e kërkuar që kundërshtojnë qëllimet legjitime të ndjekura nga ndërhyrja në çështjen në fjalë (si në *Thanza*, cituar më lart, §§ 146-47). Mbetet të konstatohet nëse ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale për të arritur ato qëllime, në kontekstin e kthimit të besimit publik në sistemin e drejtësisë përmes procesit të vetingut.

19. KPA-ja u mbështet në nenin D § 5 të aneksit të Kushtetutës për të konkluduar se një shkak i veçantë për shkarkimin lidhet me apartamentin në Golem (krahasoni *Thanza*, cituar më lart, §§ 136-37), ku zbatohet një prezumim në favor të shkarkimit nga detyra (shihni paragrafin 9 më lart). Për qëllimet e procesit të vetingut, KPA-ja i dha rëndësi tre fakteve të pakontestuar: që kërkuar e kishte përdorur apartamentin për shumë vite; që ai nuk e kishte deklaruar përdorimin e tij; dhe që kontrata e furnizimit me energji elektrike ishte lidhur me emrin e tij. Shpjegimi i kërkuar për mosdeklarimin e përdorimit të apartamentit në deklaratën e vetingut kishte lidhje me interpretimin e pasaktë të legjislacionit nga ana e tij. Ai nuk dha shpjegim tjetër bindës në KPA për atë mosdeklarim, ose për kontratën e lart-përmendur.

20. Nga gjyqtarët që për natyrën e punës së tyre konsiderohet se janë garantuesit e sundimit të ligjit duhet të kërkohej që të plotësojnë standarde veçanërisht të larta të integritetit në zhvillimin e çështjeve të tyre private jashtë gjykatës (shihni *Xboxhaj* § 407 *in fine*). Autoritetet kombëtare janë në pozitën më të mirë për të vlerësuar vështirësitë në ruajtjen e rendit demokratik në Shtetin e tyre dhe prandaj duhet t’u jepet një farë diskrecioni në lidhje me këtë vlerësim kompleks dhe specifik për vendin i cili është me rëndësi qendrore për zgjedhjet legjislative (shihni *Bala kundër Shqipërisë* (vend.), nr. 21141/20, § 72, 9 prill 2024). Përgjegjësia për shkelljen e detyrimit për të deklaruar në atë kontekst, në parim, mund

të justifikohet si “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” në ndjekje të qëllimeve legjitime.

21. Sipas Gjykatës, kjo ishte një mospërmbushje e rëndësishme nga ana e kërkuesit e detyrimit për të deklaruar – pavarësisht kërkesave të ligjit shqiptar dhe pa ndonjë shpjegim bindës në kuadër të procesit të vetingut – përdorimin e përsëritur, të vazhduar dhe falas të një pasurie të konsiderueshme (apartament) për një dekadë. Ai kishte qenë gjyqtar gjatë asaj kohe dhe kishte mbajtur pozicionin më të lartë gjyqësor në vend gjatë procesit të vetingut.

22. Kërkuesi nuk ka pretenduar dhe Gjykata nuk ka identifikuar ndonjë mangësi të rëndë në procesin e vendimmarrjes me anë të të cilit KPA-ja doli në gjetjet faktike për apartamentin në Golem (shihni edhe paragrafin 30 më poshtë). Këto gjetje, interpretimi i ligjit kombëtar dhe konkluzionet nga KPA-ja nuk duken se janë arbitrare apo haptazi të paarsyeshme. Gjykata nuk ka dhënë arsye për t’u shmangur prej tyre dhe vlerëson se arsyet e përmendura nga KPA-ja ishin edhe relevante edhe të mjaftueshme. Në fund, vërehet se në kërkesën e tij para Gjykatës, kërkuesi nuk ngriti argumente specifike që të kundërshtonin justifikimin e shkarkimit të tij nga detyra për këtë gjë (shihni edhe *Xboxhaj*, cituar më lart, §§ 412-13, dhe *Nikehasani kundër Shqipërisë*, nr. 58997/18, §§ 126 dhe 128-29, 13 dhjetor 2022, në lidhje me argumentet e tjera dhe më të përgjithshme).

23. Nisur nga sa më sipër, shkarkimi nga detyra ishte proporcional me qëllimet legjitime sipas nenit 8 paragrafi 2 të Konventës për atë shkak në rrethanat specifike të çështjes.

24. Nisur nga ky konkluzion, nuk është e nevojshme të hetohet nëse kërkuesi mund të parashikonte që rrjedhimisht atij mund t’i kërkohej të vërtetonte që huadhënësit e tij kishin paguar taksat mbi të ardhurat e huaja, nëse ishte proporcionale që atij t’i kërkohej të provonte këtë në procesin e vetingut ose nëse ndërhyrja ishte e justifikuar nga gjetjet dhe konkluzionet e KPA-së për shkaqe të tjera (krahasoni *Thanza*, cituar më lart, § 160).

25. Në këto rrethana, ankimi sipas nenit 8 është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

C. Ankimi sipas nenit 6

1. Parashtrimet e palëve

26. Kërkuesi pretendoi se zbatohet aspekti kriminal i nenit 6 *inter alia* për shkak të pasojave të rënda profesionale dhe për shkak se ai u ndoq penalisht (shihni paragrafin 10 më lart). Atij nuk i ishte dhënë ndonjë mundësi e mjaftueshme për të studiuar tërësinë e dokumenteve të mbledhura nga KPA-ja dhe KP-ja, as kohë e mjaftueshme për të përgatitur çështjen e tij, sepse proceset në apel kishin zgjatur më pak se pesë muaj dhe ai ishte zënë në befasi nga arsyetimi i KPA-së. Shkarkimi i tij u shqyrtua për herë të parë më 12 dhjetor 2018. Vendimi për shkarkimin u mor pa ndonjë njohuri paraprake apo argument ose debat mbi shkeljen disiplinore që dyshohej se kishte kryer. KP-ja u mbështet në “fakte dhe rrethana të pa treguara në dukje” për “marrëveshjen e huas” së M.D. (të cilën ai e mohoi) dhe pretendimin për mospërputhjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të kërkuesit nga 2010 deri në 2015. KPA-ja nuk përmendi arsye të mjaftueshme për të refuzuar disa prova si “të panevojshme” dhe nuk vlerësoi provat e pranura në dosje.

27. Qeveria pretendoi se nuk zbatohet aspekti kriminal i nenit 6 dhe se kërkuesit i ishte dhënë një mundësi efektive për të mbrojtur çështjen e tij përpara organeve të vetingut.

2. Vlerësimi i Gjykatës

28. Edhe nëse supozohet se *actus reus* e ndjekjes penale të veçantë që në vitin 2021 (shihni paragrafin 10 më lart) është mbivendosur me objektin e çështjes së vetingut për të cilin është marrë vendim përfundimtar në vitin 2019, kjo nuk e bën të zbatueshëm për këtë të fundit aspektin penal të nenit 6, edhe pse në një kontekst tjetër, *A dhe B kundër Norvegjisë* [DHM], nr. 24130/11 dhe 29758/11, §§ 122-34, 15 nëntor 2016). Argumentet e tjera të kërkuesit janë të ngjashme me ato të rrëzuara në *Xboxhaj* (cituar më lart, §§ 235 dhe 240-46). Gjykata nuk gjen arsye për t’u shprehur ndryshe në këtë çështje.

29. Zbatohet aspekti civil i nenit 6 § 1 në lidhje me “të drejtat dhe detyrimet civile” të kërkuesit (shihni *Xboxhaj* cituar më lart, §§ 236-38). Ai ishte palë në proces gjyqësor me natyrë disiplinore dhe bazuar në gjetjet paraprake të faktit dhe ligjit të arritura fillimisht nga një hetim administrativ dhe – në këtë çështje – në konkluzionet e KPK-së për themelin e çështjes dhe në pikat e ankimit të paraqitur nga KP-ja përpara KPA-së (krahasoni *Thanza*, cituar më lart, § 97). Prandaj, kërkuesit duhej t’i jepej

mundësia e mjaftueshme për të kundërshtuar këto pika të ankimit dhe për të mbrojtur çështjen e tij në mënyrë efektive (ibid., dhe *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, § 122, 13 dhjetor 2022).

30. Nuk ka pasur mangësi të rënda në lidhje me të drejtën e kërkuarit për një proces gjyqësor të drejtë për apartamentin në Golem. Ai nuk ka ngritur çështje të pranueshme për të kontestuar që ishte shqyrtuar në mënyrë të drejtë përpara KPK-së dhe pastaj KPA-së. Atij i është dhënë mundësi e mjaftueshme për të kundërshtuar pikat e ankimit të KP-së dhe për të mbrojtur çështjen e tij në mënyrë efektive.

31. Në lidhje me aspektet e tjera të çështjes së vetingut dhe pretendimet procedurale të kërkuarit në lidhje me to (shihni paragrafin 26 më lart), argumentet e KP-së për diferencën e të ardhura dhe shpenzimeve të kërkuarit u shprehën në ankimin e KP-së. Ai paraqiti gjithashtu llogaritjet për çdo vit, të specifikuar, bazuar në të dhënat e marra nga dosja përpara KPK-së, me të cilën kërkuari ishte njohur. Në lidhje me “kontratën e huas” me M.D., duket se kjo kishte të bënte me një kredi bankare të dyshuar të marrë nga ai në vitin 2014. Kjo u përmend në ankimin e KP-së dhe kërkuarit ju dha mundësia për të komentuar në lidhje me atë. Ajo rrethanë më pas nuk luajti rol të veçantë në gjetjet e KPA-së. Nuk ka të dhëna se kërkuari “është zënë në befasi” (shihni *Vegotex International S.A. kundër Belgjikës* [DHM], nr. 49812/09, §§ 134-36, 3 nëntor 2022) nga ndonjë element i rëndësishëm i vendimit të KPA-së dhe që në thelb do të ndryshonte nga ajo që ishte shqyrtuar nga KPK-ja, ose ngritur nga KP-ja përpara KPA-së, që kishte kompetencë të plotë mbi pyetjet e faktit dhe të ligjit (shihni *Xboxhaj*, cituar më lart, §§ 286, 334 dhe 416).

32. Në lidhje me dokumentet e refuzuara nga KPA-ja si “të panevojshme” (shihni paragrafët 8, 9, dhe 29 më lart), ai organ kishte kompetencë të vendoste për rëndësinë e provave të paraqitura. Edhe pse KPA-ja nuk i vlerësoi dokumentet nga Gjykata Kushtetuese për një aspekt dytësor të vetingut, kjo nuk ndikoi në drejtësinë e përgjithshme në këtë çështje. Në lidhje me deklarinë e M.D., kërkuari i konfirmoi KPA-së se ishte në thelb i njëjtë me provën që ndodhej tashmë në dosje. Dokumentet në lidhje me KP-në nuk kishin ndikim të drejtpërdrejtë në (ri-)vlerësimin e çështjes së vetingut. Trajtimi nga KPA-ja i asaj prove të propozuar nuk ishte arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm sipas aspektit civil të nenit 6 § 1 (shihni *Thanza*, § 102, dhe *Sevdari*, §§ 125 dhe 130-31, të dy cituar më lart; dhe *Grosam kundër Republikës Çeke* [DHM], nr. 19750/13, §§ 130-33, 1 qershor 2023).

33. Disa nga gjetjet e tjera të KPA-së kishin të bënin me ngjarjet që u zhvilluan gjatë një kohe mjaft të gjatë dhe në lidhje me detyrimet tatimore të personave të tjerë (për parime të përgjithshme në lidhje me nenin 6 § 1, shihni *Xboxhaj*, §§ 348-49; *Sevdari*, § 130; dhe *Thanza*, §§ 103-07, të gjithë cituar më lart). Nuk duket se kërkuari është shprehur zyrtarisht që nuk e kishte më në dispozicion çdo provë në lidhje me ato gjetje (shihni *Xboxhaj*, §§ 136 dhe 351). Personat në fjalë ishin bashkëpunues me subjektin e vetingut (kërkuari) dhe organet e vetingut dhe nuk krijuan pengesë ose armiqësi, duke e ndihmuar që të njihet me dokumentet. Një tjetër aspekt i pretendimeve të kërkuarit në këtë drejtim është që ai paraqiti dokumente për të provuar përmbushjen e detyrimeve financiare të mëparshme të të tjerëve, por KPA-ja nuk i vlerësoi ato. Sipas Gjykatës, KPA-ja nuk vlerësoi provat e kërkuarit, por i gjeti ato të pamjaftueshme ose jobindëse (shihni, në veçanti, paragrafët 7 dhe 9 më lart). Gjykata nuk ka ndonjë arsye për të arritur në një konkluzion tjetër sipas nenit 6 § 1 (krahasoni *Sevdari*, § 131). Në rrethanat e kësaj çështjeje (shihni edhe paragrafët 23 dhe 30 më lart) drejtësia e përgjithshme e procesit të vetingut nuk u ndikua as nga kjo.

34. Pretendimet e tjera të kërkuarit nuk tregojnë as shfaqjen e shkeljes së të drejtës së tij për seancë dëgjimore të drejtë sipas nenit 6 § 1 (shihni *Nikehasani*, cituar më lart, § 78).

35. Ankimi sipas nenit 6 është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim, më 14 nëntor 2024.

Olga Chemishova
Zëvendëskancelare

Ioannis Ktistakis
Kryetar